

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË CMIMIT TE UNIFIKUAR TE SHITJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE PËR TE LIÇENSUARIT PER PRODHIMIN E ENERGJISE NGA HEC-et ME FUQI TE INSTALUAR DERI NE 10 MW

Autoriteti

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për shitjen e energjise elektrike të prodhuar për të licencuarit për prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW, është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (me të gjitha ndryshimet)

Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është të përcaktojë një çmim unik të shitjes së energjise elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW, bazuar në rolin dhe përgjegjësitë e ERE-s për (i) nxitjen e efikasitetit në veprimtarinë e prodhimit të energjise elektrike të të licencuarve; (ii) nxitjen e investimeve të reja si në zgjerimin e burimeve ekzistuese, ashtu dhe në burime të reja në sektorin e prodhimit të energjise elektrike, duke rritur transparencën e procesit, mosdiskriminimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë për pjesëmarrjen e sektorit privat në tregun e prodhimit të energjise elektrike.

1. Termat e përdorur në metodologji

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë:

- 1.1 **Çmimi unik** – çmimi i njejte i shitjes se energjise elektrike i percaktuar nga ERE sipas kesaj metodologjie per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW.
- 1.2 **Çmimi mesatar i shitjes me pakice tek klientët tarifore ne shperndarje** – cmimi i percaktuar nga ERE per periudhen per te cilen percaktohet **çmimi unik**, qe mer ne konsiderate strukturen e shitjes te parashikuar ne aplikimin e sh.a. KESH –it per rishikimin e cmimeve te shitjes me pakice per te njejten periudhe.
- 1.3 **Klientët tarifore ne shperndarje** – Klientët fundore që nuk janë Klientë të Kualifikuar, qe furnizohen nga sh.a. KESH ne TM dhe TU.

2. Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

- 2.1 Kjo metodologji është hartuar mbështetur në Ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (me te gjitha

ndryshimet), aktet e tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

- 2.2 Energjia elektrike e prodhuar nga te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, injektohet direkt ne rrjetin TM/TU ne shperndarje), blihet nga KESH sh.a. me qellim rishitjeje tek klientet tarifore qe furnizohen ne rrjetin e shperndarjes.
- 2.3 Çmimi unik llogaritet duke iu referuar çmimit mesatar te shitjes me pakice te energjise elektrike tek klientet tarifore qe furnizohen ne rrjetin e shperndarjes.
- 2.4 Cmimi unik, sipas kesaj metodologjie, do te rregullohet ne funksion te ndryshimeve te çmimit mesatar te shitjes me pakice te energjise elektrike tek klientet tarifore ne shperndarje, te tarifes se sherbimit te transmetimit, si dhe te nivelit te humbjeve teknike ne shperndarje te pranuar nga ERE per qellim te percaktimit te cmimit unik.
- 2.5 Çmimi unik llogaritet per te gjithë prodhuesit e licensuar nga ERE per veprimtarine e prodhimit te energjise elektrike nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW.

3. Formula e llogaritjes se cmimi unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW

- 3.1 Çmimi unik i shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, percaktohet nga ERE.
- 3.2 Per te gjithë te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga HEC-et me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, çmimi unik llogaritet sipas formules se meposhtme:

$$P_U = (P_R - P_T) * (1 - L_D \%)$$

ku :

P_U – Çmimi unik i prodhuesve me fuqi te instaluar deri ne 10 MW

P_R – Çmimi mesatar i shitjes me pakice i energjise elektrike tek klientet tarifore ne shperndarje

P_T – Tarifa e sherbimit te transmetimit e miratuar nga ERE

$L_D\%$ - % e humbjeve teknike ne rrjetin e shperndarjes e pranuar nga ERE per efekt te llogaritjes se çmimit unik sipas kesaj formule.

4 Dispozita përfundimtare

Metodologjia e llogaritjes çmimit unik për prodhuesit me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të licencuar nga ERE për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, u miratua nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike me Vendimin nr.5, datë 26/01/ 2007.